



Proçesverbal i Takimit të 13-të të Grupit të Aktorëve
për
Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

24 Qershor, 2016
Hotel Enkelana, Bashkia Pogradec

Republika e Shqipërisë



Pjesëmarrësit në takim:

Struktura e pjesëmarrësve në takimin e 13-të të Grupit të Aktorëve për rajonin ndërkufitar “Prespa” ka përfshirë 34 pjesëmarrës nga Rajoni i Prespës. Takimi u organizua dhe u lehtësua nga Stafii i Njësise së Menaxhimit të Projektit me asistencën e Presidentes dhe Zëvendës-Presidentit të Grupit të Palëve të interesuara për rajonin ndërkufitar “Prespa”.

Lista e plotë e pjesëmarrësve dhe detaje për kontaktet e tyre mund të gjenden në:

ANNEX 1: Lista e pjesëmarrësve të takimit të 13-të të grupit të aktorëve për rajonin ndërkufitar “Prespa” 24.06.2016

ANNEX 2: PPP_Prespa arritjet dhe rezultatet Mars 2016 – Qershor 2016

ANNEX 3: Grant Skema e dytë ABDA_“Prespa”_ENG

Programi i takimit:

Takimit i 13-të i Grupit të Aktorëve Për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

10:00 – 10:30 Mbërritja e pjesëmarrësve dhe takimi i mirëseardhjes

10:30 – 10:45 Fjalimi i mirëseardhjes

Z. Avdulla Cano, Nën Kryetar, Bashkia Pogradec

Z. Arian Merolli, Përgjegjës i Sektorit të Projekteve, Bashkia Pogradec

Znj. Viola Bogdani, Presidente e Grupit të Aktorëve për Rajonin “Prespa”

Z. Naume Tashovski, Zëvendës President i Grupit të Aktorëve për Rajonin “Prespa”

Znj. Bojana Jovanovska, Menaxhere Rajonale për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

10:45 – 10:50 Prezantimi i programit

Znj. Bojana Jovanovska, Menaxhere Rajonale për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

10:50 – 11:15 Arritjet e përgjithshme të zbatimit të ABDA në Rajonin Ndërkufitar “Prespa” (periudha Mars 2016 – Qershor 2016)

Vizibiliteti dhe mbështetja në vazhdimësi për aktivitetet “Njerëzit për Njerëzit” në rajonin “Prespa”

Znj. Etleva Thimo, Koordinatore Rajonale për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

11:15–11:30 Diskutim dhe miratimi i Protokollit Operacional dhe Rregullat e procedurës për grupin e aktoreve “Prespa”

Znj. Etleva Thimo, Koordinatore Rajonale për Rajonin Ndërkufitar



“Prespa”

Znj. Bojana Jovanovska, Menaxhere Rajonale për Rajonin Ndërkufitar

“Prespa”

11:30 – 11:50 **Pushim kafe**

11:50 – 12:15 **Diskutim rreth aktiviteteve te ardhshme ne lidhje me zbatimin e ABDA ne Rajonin Nderkufitar "Prespa"**

Vendosja e partneriteteve në vazhdimësi rreth thirrjeve për aplikime në rajonin ndërkufitar “Prespa”

Znj. Bojana Jovanovska, Menaxhere Rajonale për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

12:15 – 13:30 **Skema e Granteve ne projektin LEIWW**

Znj. Bojana Jovanovska, Menaxhere Rajonale për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

Z. Darko Buzarovski, Oficer terreni për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

13:30 – 13:40 **Konkluzionet dhe aktivitetet e ardhshme**

13:40 – 15:00 **Dreka tek Hotel Enkelana**

15:00 **Kthimi**

Procesverbali i takimit

Takimi u hap me fjalën e mirëseardhjes të Koordinatorës Rajonale për rajonin ndërkufitar "Prespa" Znj. Etleva Thimo, e cili falenderoi për mikëpritjen e takimit të 13-të Bashkinë Pogradec, si edhe gjithë pjesëmarrësit për prezencën dhe uroi një bashkëpunim të frutshëm në vazhdim.

Në emër të Bashkisë Pogradec përshëndeti nën kryetari i Bashkisë Z. Avdulla Cano, i cili falenderoi gjithë pjesëmarrësit dhe shprehu kënaqësinë për përfshirjen në aktivitete të tilla të rëndësishme në rajonin ndërkufitar. Gjithashtu, ai shprehu optimizmin dhe mbështetjen maksimale të Bashkisë Pogradec për një bashkëpunim sa më të frutshëm edhe në të ardhmen. Në vazhdim Z. Arian Merolli, përgjegjës i departamentit të projekteve pranë Bashkisë Pogradec, theksoi vlerën e cmuar që ka organizimi i aktiviteteve të tilla si edhe rëndësinë e bashkëpunimit ndërkufitar për rajonin e Prespës në kuadër të Rezerës Ndërkufitare Biosferë Ohër – Prespë.

Më pas Znj. Viola Bogdani Presidente e Grupit të Aktorëve për Rajonin “Prespa” dhe Z.Naume Tashovski, Zëvendës President i Grupit të Aktorëve për Rajonin "Prespa" përshëndetën të gjithë pjesëmarrësit duke theksuar rëndësinë e takimeve të tilla dhe vazhdimin e bashkëpunimit të suksesshëm me të gjithë grupin e aktorëve.

Në vazhdim, Znj. Bojana Jovanovska prezantoi në detaje programin e takimit duke u ndalur në çdo sesion të programit dhe çështjeve për tu trajtuar.



Sesioni 1

Përmbledhje e arritjeve të përgjithshme në lidhje me zbatimin e ABDA në rajonin ndërkufitar "Prespa" (Mars 2016 - Qershor 2016) Vizibiliteti dhe mbështetja e veprimeve "Njerëzit për Njerëzit" në rajonin "Prespa"

Seanca filloi me prezantimin e Znj. Etleva Thimo, Koordinatore Rajonale për rajonin ndërkufitar "Prespa", e cila pasi falenderoi grupin për pjesëmarrjen, pasqyroi aktivitetet e kryera dhe arritjet e përgjithshme të zbatimit ABDA për periudhën Mars 2016 – Qershor 2016.

Prezantimi u fokusua në ecurinë dhe detajet e veprimeve të ndërmarra në tre mujorin e fundit, arritjeve të përgjithshme, informimin për mbështetjen dhe konsulencën e grupit të palëve të interesuara në përgatitjen e projekt propozimeve si dhe detaje për organizmin e aktiviteteve Njerëzit për Njerëzit në rajonin Prespa. Në përfundim të prezantimit u vazhdua në një diskutim të hapur me pjesëmarrësit dhe rahjen e mendimeve për aktivitete të ardhshme në rajonin e Prespës.

Gjatë diskutimit të hapur për organizimin e aktiviteteve Njerëzit për Njerëzit, u sugjerua që për aktivitetin konkret "Forumi i Biznesit Prespa" të zhvillohen partneritete të ndryshme me qëllim mirë organizimin e eventit. Bashkia e Korçës sugjeroi shtyrjen e aktivitetit për vitin e ardhshëm 2017 dhe bashkëorganizmin e tij me eventin e Panairit të Punës. Në vazhdim të diskutimeve ide të ndryshme u ndanë për organizimin e eventit lidhur me bashkëpunimin e grupeve të ngritura në këtë fushë në qytetin e Korçës si edhe finalizimin e eventit deri në fund të vitit 2016. Diskutimet konkluduan se Bashkia e Resnjës do të përgatisë dhe dërgojë aplikimin si organizatore e eventit për "Forumit e Biznesit Prespa", ndërkohë që Bashkia e Korçës do të mbështesë idenë si një partner potencial për aktivitetin.

Në lidhje me aktivitetin e shtyrë "Seminari rajonal për promovimin e rajonit ndërkufitar Prespa si një destinacion turistik" aktori potencial për realizimin e eventit, organizata DMO, sugjeroi që të vazhdojë me organizimin e eventit brenda vitit 2016, me konkretisht në Shtator 2016 dhe ta lidhë zhvillimin e aktivitetit me një tjetër projekt që organizata zbaton.

Gjithashtu, në lidhje me aktivitetin e para aprovuar për mbështetje "Festa e Mollës", u sugjerua që partneritetet për organizimin e aktivitetit mund të zgjerohen edhe me organizatën Agrinet dhe Ress Group kooperativat në Resnjë dhe Bashkinë Korçë. Gjithashtu, u konkludua se Njësia për Menaxhimin e Projektit do të lehtësojë partneritetet dhe bashkëpunimin për organizimin e aktivitetit.

Në vazhdim u sugjerua se Njësia për Menaxhimin e Projektit do të ndajë sërish formatin portofol me grupin e aktorëve të palëve të interesuar, me qëllim mbledhjen e informacionit për plotësimin e databazës të projekteve të zbatuara (projekte gjithëpërfshirëse) në rajonin Prespa të përgatitur nga organizata DMO.

Në lidhje me aktivitetet e ardhshme, "Festa e Ëmbëlsirave" u sugjerua si një aktivitet potencial për mbështetje nën programin Njerëzit për Njerëzit nga Bashkia Maliq. Në vazhdim, u ra dakort që informacioni i mëtejshëm rreth organizimit të eventit do të dërgohet tek Njësia për Menaxhimin e Projektit. Gjithashtu "Festivali i Verës" u sugjerua si një aktivitet tjetër potencial për tu mbështetur nën programin Njerëzit për



Njerëzit nga Bashkia Pogradec. Në vazhdim, antarë të grupit sugjeruan që ide dhe projekt ide të tjera mund të zhvillohen si aktivitete potenciale që mund të mbështeten në programin Njerëzit për Njerëzit.

Gjatë diskutimit u konkludua se Njësia për Menaxhimin e Projektit dhe SWG do të vazhdojnë të shërbejnë si një pikë informuese ku antarë të grupit të palëve të interesuara do të marrin informacionin e nevojshëm për programe dhe thirrje për aplikime të reja. Faqja zyrtare e internetit (web) aktive dhe faqja e Facebook për rajonin ndërkuftar Prespa do të pasurohet me informacion relevant me qëllim rritjen e vizibilitetit dhe promovimin e punës të grupit të palëve të interesuara në rajon. Gjithashtu antarët e grupit të palëve të interesuara duhet të dërgojnë informacione relevante tek Njësia për Menaxhimin e Projektit me qëllim ndarjen dhe rritjen e ndërgjegjësimit për veprime dhe aktivitete të zbatuara në rajon. Njësia për Menaxhimin e Projektit do të vazhdojë të mbështesë përgatitjen e aplikimeve për thirrje të ndryshme si edhe do të lehtësojë partneritete të mundshme për thirrje aktive të programeve IPA CBC në rajon dhe thirrjeve të tjera aktive. Gjithashtu, Njësia për Menaxhimin e Projektit do të vazhdojë të targetojë dhe lehtësojë rrjetëzimin midis palëve të interesuara publike dhe private për të aplikuar në thirrje të ndryshme.

Sesioni 2

Diskutim rreth Protokollit Operacional dhe Rregullat e procedurës për grupin e aktorëve “Prespa”

Gjatë këtij sesioni Znj. Etleva Thimo prezantoi shkurtimisht të gjitha ndryshimet e bëra në dokument sipas sugjerimeve dhe komenteve nga aktorët e grupit të palëve të interesuara gjatë takimit të fundit të 12-të tek Qendra e Informacionit të Parkut Kombëtar Pelister.

Kështu, duke parë rëndësinë e këtij dokumenti, antarët e grupit të palëve të interesuara sugjeruan të bënin disa ndryshime të tjera në dokument në lidhje me qartësimin e nenve 3 dhe 12. Kështu antarët e grupit të palëve të interesuara sugjeruan që përgjegjësitë e Kryetarit, Presidentit dhe zëvendës Presidentit të grupit të palëve të interesuara duhet të specifikohen më qartë rreth rolit dhe përgjegjësi në një aneks të vecantë. Gjithashtu u ra dakort se komentet do të dërgohen nga aktorët e grupit të palëve të interesuara dhe Njësia për Menaxhimin e Projektit do të përgatisë aneksin me informacion relevant.

Gjithashtu në lidhje me nenin 12, rreth vendimarrjes dhe votimit brenda grupit të palëve të interesuara në pikën 1, u sugjerua të sqarohet e drejta e votimit brenda grupit të aktorëve. Në këtë kuadër u sugjerua që vendimet brenda grupit të aktorëve duhet të ndërmerren nëse të paktën 2/3 e të gjithë aktorëve të grupit të palëve të interesuara të emëruar zyrtarisht (duke mos përfshirë Kryetarin dhe zëvendësit) janë prezentë.

Sugjerimet finale do të bashkangjiten në dokumentin e Protokollit Operacional për grupin e aktorëve “Prespa” dhe Rregullores së punës dhe dokumenti do të ndahet sërish me grupin e aktorëve si edhe do të diskutohet për miratim në mbledhjen e ardhshme.



Sesioni 3

Skema e Granteve në projektin LEIWW

Sesioni filloi me prezantimin e Z. Darko Buzarovski, Oficer Terreni për Rajonin Ndërkufitar "Prespa". Prezantimi u fokusua në pasqyrimin përmbledhës së Skemës së dytë të Grantit ABDA për zhvillimin e integruar ekonomik. Përveç kësaj u dhanë informacione të detajuara në lidhje me objektivat kryesore të Thirrjes për Grant dhe udhëzuesit për aplikantët. Shpjegime të mëtejshme u dhanë për secilën çështje duke theksuar rëndësinë e zhvillimit të integruar ekonomik përmes lehtësimit të rretëzimit dhe bashkëpunimit në rajonet ndërkufitare. Sesioni vazhdoi me diskutim të hapur për komente dhe sugjerime.

Gjatë diskutimit aktiv u sugjerua se në lidhje me aplikantët e mundshëm dhe shtrirjen rajonale, qyteti i Bitolës dhe palet e interesuara nga territori i Bashkisë së Bitolës të shtohen duke u konsideruar si aplikantë të mundshëm për Skemën e granteve ose për mbështetje në vazhdimësi. Në vazhdim të diskutimeve shpjegime të mëtejshme u dhanë në lidhje me qatësimin e pyetje të ndryshme rreth procedurave të aplikimit, partneriteteve dhe kriterëve të Skemës së Grantit. Antarët e grupit të aktorëve u udhëzuan të drejtonin pyetje të mëtejshme në emailin e publikuar zyrtar për rajonin e Prespës.

Në përfundim të diskutimeve u ra dakort që Njësia për Menaxhimin e Projektit do të vazhdojë të mbledhë dhe zhvillojë veprime dhe ide që mund të mbështeten përmes skemës së granteve ose programit Njerëzit për Njerëzit.

Sesioni 4

Konkluzione dhe mbyllja e takimit

Në sesionin e fundit u dhanë konkluzionet si mëposhtë:

- Njësia për menaxhimin e projektit "Prespa" dhe SWG do të shërbejë si një pikë informative ku antarët e grupit (SHG) të marrin informacione e nevojshëm për thirrje të reja për projekt propozime. Ata do të vazhdojnë të mbështesin në përgatitjen e aplikimeve për projekt propozime të ndryshme si edhe do të lehtësojnë partneritetet për programe aktive IPA, CBC në rajon;
- Faqja zyrtare aktive e internetit dhe faqja zyrtare në Facebook për rajonin ndërkufitar Prespa do të përmirësohet me informacione relevante me qëllim rritjen e vizibilitetit dhe promovimin e punës të grupit të palëve të interesuara në rajon. Gjithashtu, antarët e grupit duhet të dërgojnë informacione relevante pranë Njesisë së Menaxhimit të Projektit me qëllim ndarjen dhe rritjen e ndërgjegjësimit për veprime dhe aktivitete të zbatuara në rajon;



- Njësia për menaxhimin e projektit do të ndajë formatin portofol me antarët e grupit të palëve të interesuara me qëllim mbledhjen dhe përmirësimin e informacionit për databazën e projekteve të zbatuara (projekte gjithëpërfshirëse në fusha të ndryshme) në rajonin e Prespës;
- Njësia për menaxhimin e projektit do të zhvillojë veprime të vazhdueshme me Bashkitë e Resnjës dhe Korçës me qëllim mbështetjen e organizimit të aktivitetit “Forumi i Biznesit Prespa”. Gjithashtu njësia për menaxhimin e projektit në bashkëpunim më antarët e grupit të aktorëve do të synojnë në mbledhjen, zhvillimin e veprime dhe ideve të tjera të cilat mund të mbështeten nga skema e granteve ose nga programi “Njerëzit për Njerëzit”;
- Njësia për menaxhimin e projektit do të lehtësojë partneritetet dhe zhvillojë veprime për organizimin e aktiviteteve Njerëzit për Njerëzit “Seminari rajonal për promovimin e rajonit ndërkufitar Prespa si një destinacion Turistik” dhe “Festa e Mollës”;
- “Festivali i Ëmbëlsirave” në Maliq dhe “Festivali i Verës” në Pogradec, u sugjeruan si aktivitete potenciale për mbështetje nën programin Njerëzit për Njerëzit. Informacion shtesë për organizimin e të dy aktiviteteve do të dergohen nga të dy Bashkitë tek njësia për menaxhimin e projektit;
- Protokollit Operacional dhe Rregullorja e procedurës për grupin e aktorëve “Prespa” do të rishikohet sërisht me komentet e sugjeruara nga antarë të grupit në lidhje me nenin 3 (tre) dhe 12 (dymbëdhjetë). Dokumenti përfundimtar do të ndahet me grupin e antarëve dhe do të miratohet në takimin e ardhshëm;
- Skema e Grantit ABDA në projektin LEIWW do të krijojë një mundësi shumë të mirë për rajonin e Prespës për të treguar kapacitetet potenciale të rajonit dhe gjithashtu të kontribuojë në përmirësimin e zhvillimit të integruar ekonomik në rajon;
- U sugjerua se qyteti i Bitolës dhe palet e interesuara nga territori i Bashkisë së Bitolës duhet të shtohen si aplikantë të mundshëm dhe potencialë për Skemën e ardhshme të Grantit ose mbështetjen në të ardhmen.

Përgatiti:

Etleva Thimo

Koordinatorë Rajonale për Rajonin Ndërkufitar të Prespës

